

PËR NJË NDARJE TJETËR NË KLASA TË FOLJEVE TË SHQIPES

1. Ndarja e foljeve në zgjedhime sipas gjedhes së gramatikës latine ka zënë vend në grammatikat e shumë gjuhëve indoeuropiane, madje edhe në gjuhë foljet e të cilave kanë paradigma tepër të ndryshme prej latinishtes. Ky klasifikim, që mbështetet në një kriter të vetëm, dhe pikërisht në zanoren nistore të prapashtesës së kësaj forme foljore, zbatohet gjithandej në gjuhët romane, të cilat i kanë ruajtur pak a shumë format e paskajores të gjuhës mëmë. Nga gjuhët e tjera i.e., me latinishten dhe me gjuhët neolatine afron edhe rusishtja, në të cilën ndiqet gjithashtu një kriter i vetëm klasifikimi, ndonëse foljet e kësaj të fundit ndahen në zgjedhime duke u mbështetur jo në formantin e paskajores, por në mbaresën e vetës së dytë të së tashmes dëftore¹.

Por në ato gjuhë ku folja ka pësuar zhvillime të thella, zbatimi i një kriteri të vetëm si në përmendura më sipër është gjë e pamundur. Kjo mund të thuhet edhe për shqipen, sistemi foljor i së cilës ka pësuar zhvillime tepër largvajtëse, duke i humbur format e paskajores dhe duke na u paraqitur sot me një paradigme të pasur në tipa eptimi.

Pikërisht, përmes një paraqitjeje të shkurtër të historisë së klasifikimit të foljeve të shqipes në zgjedhime, në këtë shkrim do të shpjegojmë pse tradita për të marrë paskajoren si bazë për ndarjen në zgjedhime është braktisur dhe pse edhe qëndrimet e tjera të ndjekura në grammatikat e shqipes nuk kanë mundur ta zgjidhin bindshëm këtë çështje. Pikërisht, ky mossakses i traditës sonë grammatikore në këtë pikë e përlligj përpjekjen për të paraqitur një skemë disi të ndryshme, e cila mendojmë se është më praktike dhe, si e tillë, e zgjidh kënaqshëm çështjen e ndarjes në zgjedhime të foljeve të shqipes.

2. Klasifikimi i foljeve të shqipes në zgjedhime ka një moshë po aq të vjetër sa dhe vetë tradita jonë grammatikore². Përpjekjen e parë për një gjë të tillë e gjejmë në «Gramatikën e Grotaferratës» (1710), autori i së cilës, duke ndjekur shembullin e latinishtes, i ka ndarë foljet e shqipes në tetë zgjedhime. Kështu, në zgjedhimin e parë përfshihen foljet me paskajoren gege më *-uum* (me cantuum /këndu:m/), në të dytin fojet me *-une* (me ditune /ditunë/), në të tretin fojet me *-le* (me folle /folë/), në të katërtin fojet me *-ane* (me dhane /dhanë/), në të pestin fojet me *-ijm* (me pijm /pi:m/), në të gjashtin fojet me *-am* (me baam /ba:m/), në të shtatin fojet me *-re* (me thirre /thirrë/) dhe në të tetin fojet me *-em* (me scerbyem /shërbyem/)³.

Në gramatikën e M. da Leçes numri i zgjedhimeve rritet në dhjetë. Edhe ky autor, duke ndjekur gjedhen klasike, në zgjedhimin e parë fut foljet me paskajoren më *-ue* (me këndue), në të dytin foljet më *-ye* (me shërbye), në të tretin foljet më *-unë* (me lidhunë), në të katërtin foljet më *-am* (me baam), në të pestin foljet më *-rrë* (me marrë), në të gjashtin foljet më *-lë* (me çelë), në të shtatin foljet më *-im* (me piim), në të tetin foljet më *-um* (me vum), në të nëntin foljet më *-em* (me blem) dhe në të dhjetin foljet më *-në* (me ngranë)⁴. Këtyre dhjetë zgjedhimeve ai u shton edhe një klasë foljesh të parregullta. Siç mund të shihet, foljet me fundore të njëjtë janë shpërndarë në zgjedhime të ndryshme. Kështu, foljet me prapashtesën *-m* janë ndarë në katër zgjedhime: në të katërtin, në të shtatin, në të tetin dhe në të nëntin; po ashtu, edhe foljet me prapashtesën *-në* janë ndarë në zgjedhimin e tretë dhe të dhjetë.

¹ Në zgjedhimin e parë të foljeve të rusishtes futen foljet me *-esh'* (*rabotat' – rabota-esh*), kurse në të dytin foljet me *-ish'*, (*stroit' – stroish'*, *smotret' – smotrish'*).

² Për historinë e klasifikimit të foljeve të shqipes në zgjedhime, shih Sh. Demiraj (shih Sh. Demiraj, Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime, SF, 1969, 3. f. 193–194) dhe, më hollësisht, për fillimet e këtyre klasifikimeve e gjer te «Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II: Morfologjia» (1976), shkrimin e G. Bevingtonit “Rreth klasifikimit të foljeve të shqipes” (G. L. Bevington, *On Classifying Albanian Verbs*, Papers for the Vth Congress of Southeast European Studies, Belgrade, September 1984, pp. 53–59).

³ Shih R. Ismajli, Gramatika e parë e gjuhës shqipe, RILINDJA, Prishtinë, 1982, f. 96–119.

⁴ Da Lecce, Osservazioni grammaticali sulla lingua albanese, 1716, p. 61–66.

Ndër autorët e mëvonshëm të gramatikave të shqipes, në formën e paskajores i kanë mbështetur klasifikimet e tyre ndonjë autor i huaj, si G. Jungu, dhe pak autorë veriorë, si A. Xanoni dhe O. Myderrizi, i cili, ndryshe nga të tjerët, e mbështet klasifikimin e tij edhe në format e paskajores, edhe në format e së tashmes⁵; por edhe ndonjë autor tosk, si Iljas Jahja Përmeti⁶. G. Jungu e rruddh numrin e zgjedhimeve të shqipes në tri, duke përfshirë në zgjedhimin e parë foljet që në paskajore mbarojnë me dy zanore, si: *me shkue, me kthye, me baa, me lee, me hii* etj.; në të dytin foljet që mbarojnë me *t*, si: *me leçit, me lut, me mat* etj. dhe në të tretin foljet me çdo mbaresë tjetër⁷. Klasifikimi i Xanonit përputhet thuajse plotësisht me klasifikimin e Jungut, me dallimin që Xanoni zgjedhimin e dytë e ndan në tri klasa: (a) foljet *qes, shes, njes, ndrit, rrit, sit*; (b) foljet *përkas, kërsas, rrshas* etj.; dhe (c) foljet që në aorist e zgjerojnë temën me *t/jt*: *mbaj, di* etj.⁸

I. J. Përmeti, në librin e tij «Fillime të Gramatikës Shqipe për shkollat premetare» (1917), i njeh edhe toskërishtes paskajoren me *me: me punuar, me shërbyer, me pirë* etj. Duke marrë për bazë këtë “paskajore”, ai i ndan foljet e rregullta të shqipes në katër zgjedhime, të cilat i quan *përkthesa*: «përkthesa e parë, me *uar*; përkthesa e dytë me *yer*; përkthesa e tretë me *ur* e përkthesa e katërtë me *rë*»⁹. Në të parregulltat ky autor përfshin pak folje: *me dhënë, me ardhur, me rënë, me ngrënë, me ndenjur, me parë dhe me vrarë*¹⁰.

3. Afër me autorët e grupit të parë janë edhe dy autorë gramatikash të toskërishtes, S. Frashëri dhe K. Tasi. Meqenëse dialekti tosk nuk ka paskajore si ajo e gegërishtes, këta dy autorë janë mbështetur te forma e pjesores. Në gramatikën e vet, Samiu i ndan foljet e shqipes në pesë zgjedhime, duke marrë për bazë formën e së “paçquames”, siç e quan ai paskajoren. Po, në të vërtetë, ajo që Samiu e merr për paskajore, nuk është tjetër veçse forma e pjesores¹¹, prej së cilës formohet paskajorja analitike toske. Në klasifikimin në zgjedhime të Samiut, «përkthimi i parë pushton foljetë të cilavet e paçquemja (paskajorja–shën. ynë) mbarohetë me *arë, irë, yrë* (përkatësisht *larë, qarë, ngarë, marrë, ngarë, vrarë, parë, shkarë* etj.; *shirë, nderë, ndjerë, zjerë* etj.; *fryrë* (po jo *hyrë*, të cilën e fut në të parregulltat), përkthim i dytë ato që mbarohen më *yre*¹²; i tretë ato që mbarohen më *uarë* a *uajturë* (si *ftuarë, fituarë, lëruarë, vuajturë/vuarë, quarë/ quajturë* etj.); i katërti ato që mbarohen më *urë* a *turë* (si *varurë/ varturë, ngjallurë/ ngjallturë, rrahurë* etj.); i pesëti ato që mbarohen më *urë* a me *ë* edhe kanë një *je* a *e* në rrëmbimt q’është përsipërë këti»¹³. Siç shihet, ndonëse te Samiu numri i zgjedhimeve është shumë më i vogël, ashtu si te Da Leçja, brenda një tipi përfshihen folje që kanë paradigma të ndryshme eptimi, si p.sh. *laj, ngas, marr* dhe *shoh* apo *shij* dhe *ndiej*, që ai i përfshin të gjitha në zgjedhimin e parë. Karakteri jokoherent i këtij klasifikimi duket edhe në numrin e madh të foljeve të parregullta, që arrin në 55¹⁴.

4. Me kalimin e kohës, vërehet se tradita e klasifikimit që mbështetet në temën e paskajores vjen e ia lë vendin klasifikimit që merr si bazë temën e së tashmes. Arsyet e këtij

⁵ Sh. Demiraj, Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime, SF, 1969, 3, f. 193–194.

⁶ J. Përmeti, «Fillime të gramatikës shqipe për shkollat premetare», Boston, Mass., 1917.

⁷ G. Jung, Elementi grammaticali della lingua albanese, Scutari, 1881, p. 49.

⁸ A. Xanoni, Gramatika shqyp, Shkodër, 1909, f. 102 dhe 116–117.

⁹ I. J. Përmeti, «Fillime të Gramatikës shqipe për shkollat premetare», Boston, Mass., 1917, f. 100.

¹⁰ Po aty, f. 129.

¹¹ Sh. Demiraj vëren se jo vetëm Samiu, por edhe Tasi “marrin si paskajore format e tipit *punuar, bërë* etj.” (Rreth klasifikimit..., art. i cit., f. 193). Ne do të shtonim këtu edhe I. J. Përmetin, i cili paskajoren e toskërishtes e ndërton duke bashkuar pjesëzën *me* me formën e pjesores.

¹² Për këto folje Samiu nuk jep ndonjë shembull zgjedhimi. Këtu duhet të jetë fjala për foljet më *-yerë*, të cilat Samiu i përmend në § 137, ku thotë se “foljet e mbaruara me *yerë* e humbasin shkronjën *y* në të shkuarët dhe në të uruamët”. Si të tilla, ai përmend foljet *lyerë, thyerë, ngjyerë, ushqyerë*. (shih S. Frashëri, Shkronjëtoare e gjuhësë shqip, Bukuresht 1886, në “Vepra”, II, Tiranë, 1988, f. 167).

¹³ S. Frashëri, Shkronjëtoare e gjuhësë shqip, f. 150.

¹⁴ Po aty, f. 201–211.

ndryshimi mendojmë se janë të shumta. Në radhë të parë, siç është vënë në dukje edhe nga gjuhëtarë të tjerë, larmia e formave të paskajores dhe të pjesores së shkuar pësore në të dy dialektet e shqipes, «të përfuara si rrjedhim i evolucioneve fonetike dhe i veprimit të analogjisë», nuk lejonin dhe nuk lejojnë për t'i vënë ato në bazë të klasifikimit të foljeve në zgjedhime¹⁵. Ndoshta, autorët që i janë drejtuar së tashmes, nuk e kanë njohur traditën gramatikore latine e neolatine dhe janë ndikuar nga tradita gramatikore greke, që i ndan foljet në grupe duke u nisur nga tema e së tashmes, ose nga tradita gramatikore e gjuhëve gjermanike. Një arsye tjetër ka qenë edhe ajo që toskërishtja nuk ka një formë të paskajores si ajo e gegërishtes, ndonëse në temën e së tashmes, siç do të shohim, mbështeten edhe autorë gegë.

I pari ndër grupin e autorëve që mbështeten në temën e së tashmes, është K. Kristoforidhi, i cili, duke u nisur nga kjo temë, i ndan foljet e shqipes në 18 tipa zgjedhimi. Foljet me temë të së tashmes më zanore plus *-j*, përfshirë këtu edhe foljet e tipit *lypëj* (nga të cilat sot kanë mbetur vetëm tri: *iki*, *eci*, *hipi*) ndahen në gjashtë tipa, kurse foljet me temë më bashkëtingëllore në 11–12 tipa¹⁶.

Edhe G. Majeri, në gramatikën e tij historike të shqipes, ndarjen në folje të zgjedhimit në *-mi* dhe në folje të zgjedhimit në *-ō*, e mbështet në temën e së tashmes. Klasifikimin e Majerit e ndjek Gj. Pekmezi, i cili gjithashtu i veçon foljet e zgjedhimit në *-mi* nga ato të zgjedhimit në *-ō*, por duke ndryshuar prej Majerit në numrin e klasave dhe të nënklasave që dallon te këto të fundit¹⁷.

Te Majeri dhe te Pekmezi mbështetet edhe klasifikimi i K. Cipos. Për ndarjen e foljeve në zgjedhime, ky i fundit përzien kriterin historik me kriterin sinkronik, duke i futur foljet në *-mi* (*jam*, *kam* dhe *them*) të Majerit në grupin e foljeve të parregullta (*jam*, *kam*, *thom*, *ap*, *lë*, *bie*, *shoh*, *dua*, *ha*, *lë*, *njoh*, *rri*, *shpie*, *shtie*, *vete*, *vë* dhe *vinj*), kurse foljet e tjera i ndan në katër zgjedhime duke u mbështetur në mbaresat dhe në llojin e temës, të cilin e përkufizon si «ajo pjesë e foljes që nuk ndron me ndrimin e mënyrës, të kohës, të vetës dhe të numrit». «Radikali i foljeve të tri zgjedhimeve të para,— thotë më tej ai,— mbaron me bashkëtingëllore: radikali i të katërtit zgjedhim sos mbë zanore.»¹⁸ Kështu, në zgjedhimin e parë futen foljet më bashkëtingëllore pa ndërrime në temë (*qep*, *palos*, *kuqërris*); në zgjedhimin e dytë foljet me temë më *-t/s* ose më *-s* (*ngjit*, *ujit*, *avit*, *çudit*, *godit* etj.; *flas*, *gërshas*, *ngas*, *pres*, *godas* etj.), në zgjedhimin e tretë foljet që «mbarojnë më radikaln *-në*» dhe në të katërtin «tërë foljet që mbarojnë më zanore» (*ha*, *di*, *pi* etj.; *zë*, *nxë*, *vë*, *flë*, *shpie* etj.).

Që klasifikimi i Cipos është një përzierje e vështrimit diakronik me atë sinkronik, kjo duket qartë sidomos te zgjedhimi i tretë, ku ai përfshin foljet me radikaln *-në*, d.m.th. klasën më të madhe të foljeve të shqipes që në vetat e njëjësit marrin mbaresat *-j*, *-j* dhe *-n*. Vërtet që dikur këto folje kanë qenë me temë më *-në*, por në shqipen e sotme ato kanë përfunduar në folje me temë më zanore dhe si të tilla duhen marrë edhe në një klasifikim sinkronik. Pikërisht, kjo përzierje e këndvështrimeve, që foljet me temë më zanore i ndan në dy zgjedhime, përbën të metën kryesore të këtij klasifikimi. Kjo gjë si dhe përfshirja e foljeve me temë më zanore edhe në grupin e të rregulltave, edhe në zgjedhimin e katërt, e bëjnë klasifikimin e Cipos të pavlefshëm për shqipen e sotme, të paktën në ndarjet e tij më të mëdha.

5. Një klasifikim tjetër, të ndryshëm nga klasifikimet e gjeratëhershme, u bën foljeve të shqipes De Rada. Ky autor nuk ka zgjedhur pjesoren toske, as paskajoren gege, siç do të pritej

¹⁵ Sh. Demiraj, Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime, f. 195.

¹⁶ K. Kristoforidhi, Grammatike tis alvanikis glossis, 1882, f. 132–139.

¹⁷ Shih G. Meyer, Kurzgefasste albanesische Grammatik, Leipzig, 1888, f. 30–38 dhe Gj. Pekmezi, Grammatik der albanesischen Sprache, 1908, f. 151–153.

¹⁸ K. Cipo, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1949, f. 122. Do vërejtur që Cipoja përdor termin *radikal*, me të cilin, sipas përkufizimit që i jep, duhet kuptuar jo rrënja, po tema foljore.

të bënte një gramatikan që njëjtte mirë gramatikën latine dhe italiane. Pas gjithë gjasash, De Rada ka qenë i vetëdijshëm se mbështetja në format e paskajores nuk i shkonte për shtat foljes së shqipes. Ai nuk merr për bazë as temën e së tashmes, por numrin e temave të eptimit të foljes. Duke u mbështetur në këtë kriter, ai i ndan foljet në pesë zgjedhime. Në zgjedhimin e parë, fut «foljet që nuk e këmbejnë, në asnjë kohë, zanoren e temës»; në zgjedhimin e dytë foljet me ndërrime në të tashmen dhe të kryerën e thjeshtë, si *shes–shitni–shita* etj.; në të tretin foljet me dy-tri ndërrime, si *dredh–dridshni–drodha* etj.; në të katërtin foljet që në urdhërore dalin me dy forma, si *ngas–nga/ngit* etj.; dhe në zgjedhimin e pestë foljet me temë më zanore: *lë, vë, shtie* etj.¹⁹

6. Krahas klasifikimeve në vijën e G. Majerit apo klasifikimit të De Radës, kemi edhe një traditë tjetër që nis me G. Hanin (1854) dhe ndiqet nga A. Dozoni, I. D. Sheperi dhe S. Riza.

G. Hani foljet e shqipes i ndan në dy zgjedhime, sipas karakterit konsonantik ose vokalik të temës të së tashmes. Në zgjedhimin e parë ai fut foljet me temë më bashkëtingëllore, që i ndan në dy klasa, dhe në të dytin foljet me temë më zanore, të cilat, duke marrë për bazë zanoren fundore të temës, i ndan në shtatë klasa. Veç këtyre dy zgjedhimeve, Hani jep edhe një listë prej 18 foljesh të parregullta²⁰. Klasifikimi i A. Dozonit është i ngjashëm me atë të Hanit. Edhe Dozoni në zgjedhimin e parë përfshin foljet me temë më bashkëtingëllore, të cilat i ndan më tej në folje me temë të ndryshueshme dhe me temë të pandryshueshme, kurse në zgjedhimin e dytë foljet të cilave tema u mbaron më zanore. Këtyre dy zgjedhimeve ai u shton edhe një grup foljesh të parregullta²¹.

I ngjashëm me klasifikimet e dy autorëve të mësipërm është edhe ai i I. D. Sheperit, i cili gjithashtu i ndan foljet e shqipes në dy zgjedhime: në të parin «foljet që kanë karakter zërore ose dyzanor, si *shkrua-j, kërkë-j, dëfte-j, thye-j, fshi-j, fry-j, la-j* etj.»; ndërsa në zgjedhimin e dytë «foljet që kanë karakter bashkëtingëllore, si: *çel, prish, tret, lidh* etj.»²². Përveç këtyre, Sheperi jep edhe një listë prej 51 foljesh të parregullta. Ndryshimi kryesor midis këtyre dy autorëve është se të Sheperi rendi i zgjedhimeve del i përmbysur. Me sa duket, ky i fundit nisat nga kriteri sasior, duke qenë se foljet me temë më zanore përbëjnë pjesën dërrmuese të leksikut foljor të shqipes. Një ndryshim tjetër është se Dozoni foljet e zgjedhimit të parë i ndan në dy grupe, duke u mbështetur në numrin e temave, ndërsa te Sheperi këto ndahen në folje me temë më *-s/t* dhe folje me çdo bashkëtingëllore tjetër, pavarësisht nga numri i temave të eptimit. Përveç kësaj, Sheperi foljet me temë më zanore që nuk marrin mbaresa në tri vetat e njëjësit të së tashmes, i fut në të parregulltat. Kjo ka bërë që folja *pi* dhe ndonjë tjetër e ngjashme me të, që janë të rregullta, të mos përmenden as në zgjedhimin e parë dhe as në listën e foljeve të parregullta. Pavarësisht nga vërejtjet që mund t'u bëhen, dy klasifikimet e fundit, ndryshe nga ato që nisen nga këndvështrimi diakronik, janë më të pranueshme, pasi ndërtohen duke u mbështetur në vështrimin sinkronik të foljeve të shqipes. Megjithatë, tradita e tyre nuk u ndoq në gramatikat e mëvonshme të shqipes²³.

S. Riza i ndan foljet «në zgjedhime, nënzgjedhime dhe klasa simbas tre kriteresh të shkallëzuar, nxjerrë nga *temat* dhe “*fundjet*” prkt. *mbaresat* të tri formave kyçe...» Foljet ndahen në dy zgjedhime “simbas asaj që tema u del në zanore (qoftë të shndërrueshme qoftë të pashndërrueshme në një dyzanor) apo përkundrazi në një bashkëtingëllore”²⁴. Më tej, foljet e secilit zgjedhim ndahen në nënzgjedhime duke marrë si kriter mbaresën e paskajores. Kështu, në nënklasën e parë përfshihen foljet të cilave paskajorja u del më *-uar* (geg. *-ue*), *-yer* (*-ye*) dhe *-ur* (në foljet e zgjedhimit të dytë), kurse në nënzgjedhimin e dytë foljet me

¹⁹ G. de Rada, Grammatica della lingua Albanese, Firenze, 1871, p. 70–77.

²⁰ J. G. Hahn, Grammatik der Toskischen Dialektes, Albanesische Studien, Heft II, Wien, 1854, f. 66–85.

²¹ A. Dozon, Manuel de la langue chkiye ou albanaise, Paris, 1879, p. 251–252.

²² I. D. Sheperi, Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, Vlorë, 1927, f. 82.

²³ Shih edhe Sh. Demiraj, Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime, art. i cit., f. 193–194.

²⁴ S. Riza, Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare kombëtare, f. 167.

paskajoren më *-rë* (geg. *-m*) dhe *-ë* (te foljet e zgjedhimit të dytë). Foljet e çdo nënzgjedhimi ndahen pastaj në klasa duke u mbështetur në barazinë ose mosbarazinë e temës të së ashmes dhe temës të së kryerës së thjeshtë²⁵.

7. Në temën e së tashmes e mbështet klasifikimin e foljeve të toskërishtes letrare dhe të gjuhës standarde edhe Sh. Demiraj. Sikurse pohon ky autor, klasifikimi i dhënë prej tij në tekstin universitar «Morfologjia e gjuhës së sotme letrare shqipe, I», (1961), në vija të përgjithshme, mbështetet në kriteret e Pekmezit dhe të Cipos, me ndryshimin që nuk e pranon zgjedhimin e katërt, duke i trajtuar shumicën e foljeve të këtij zgjedhimi si të parregullta. Një ndryshim tjetër, është se renditja e tipave të zgjedhimit te Demiraj është e përmbytur²⁶.

Demiraj është autori i parë që flet për kriteret klasifikimi, duke theksuar se për ndarjen e foljeve të shqipes në zgjedhime duhen ndjekur gjashtë kriteret: (1) Si bazë duhet marrë leksiku foljor i shqipes së sotme letrare, i parë në planin thjesht sinkronik; (2) Folja eptimi i së cilës «paraqet parregullsi të tilla, që nuk i lejojnë të grupohet me folje të tjera, duhet lënë jashtë klasifikimit në zgjedhime, duke u trajtuar si e parregullt»; (3) Si kriter më i përshtatshëm që duhet ndjekur, është karakteri i temave foljore; (4) Tema në të cilën duhet të mbështetemi për klasifikimin në zgjedhime, është tema e «kohës së tashme të mënyrës dëftore në diatezën veprorë»; (5) Për ndarjen e mëtejshme «në nënzgjedhime e klasa, duhet mbështetur edhe në temën e së kryerës së thjeshtë e në disa raste edhe në atë të pjesores»; (6) Për renditjen e zgjedhimeve dhe të klasave «duhet marrë parasysh sasia numerike e foljeve»²⁷.

I mbështetur në këto kriteret, në shkrimin «Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime» (1969), autori propozon dy skema të mundshme klasifikimi: njëra me tri dhe tjetra me dy zgjedhime. Në variantin me tri zgjedhime, që është po ai që gjejmë në tekstin e sipërpërmendur, në zgjedhimin e parë autori përfshin «foljet me temë më zanore ose tog zanoresh, si *puno-j*, *rrëfe-j*, *shkrua-j*, *lye-j* etj.»; në zgjedhimin e dytë «foljet me temë më çdo bashkëtingëllore përveç foljeve të tipit *mas/mat*, *shkas/shket*, që alternojnë tingullin fundor të temës»; dhe në zgjedhimin e tretë «foljet e tipit *mas/mat*, *shkas/shket*, që alternojnë tingullin fundor *-s/-t*»²⁸. Secili zgjedhim ndahet në klasa e nënklasa në bazë të kriterëve të tjera. Në variantin e dytë, zgjedhimi i parë përfshin «foljet me temë në zanore ose tog zanoresh, si *puno-j*, *shkrua-j* etj.», kurse zgjedhimi i dytë «foljet me temë në bashkëtingëllore, si *hap*, *mat* etj.». Pra, në këtë variant më të thjeshtë, që ishte më i thjeshtë dhe, për këtë arsye, më i pëlqyeshëm²⁹, zgjedhimi i dytë dhe i tretë rrudhen në një të vetëm, në zgjedhimin e dytë. Në të dyja variantet jepet edhe një listë prej 16 foljesh të parregullta, që ndahen në folje supletive dhe josupletive³⁰.

8. Por në kreun e foljes (të shkruar nga Sh. Demiraj) të tekstit akademik «Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe», jepet një variant me tri zgjedhime, i ndryshëm nga varianti i propozuar prej tij në shkrimin rreth klasifikimit në zgjedhime. Këtu foljet me temë më zanore janë ndarë në dy zgjedhime: foljet me temë më zanore plus *-j* në të parin, kurse foljet me temë thjesht më zanore dhe diftongje janë nxjerrë më vete dhe, për shkak të kriterit të prodhimtarisë, janë futur në zgjedhimin e tretë. Zgjedhimi i dytë përfshin foljet me temë të së tashmes më bashkëtingëllore.

Kemi të bëjmë me një klasifikim që nuk haset në asnjë prej gramatikave të mëparshme të shqipes dhe kjo e bën atë më të diskutueshëm. Ky klasifikim jo vetëm që nuk i jep një zgjidhje përfundimtare çështjes, por e ndërliq edhe më shumë atë. Në këtë gramatikë, për

²⁵ Po aty, f. 167.

²⁶ Sh. Demiraj, Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime, art. i cit., f. 194.

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty, f. 196.

²⁹ Shih edhe T. Osmani, Disa çështje rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime, SF, 1972, 2, f. 155.

³⁰ Po aty, f. 196–201.

ndarjen në zgjedhime ndiqen tri kritere njëherësh: karakteri i fundores së temës, mungesa e mbaresave në tri vetat e njëjësit të së tashmes dëftore dhe kriteri sasior, kur pritej që për ndarjen themelore të ndiqej një kriter i vetëm— karakteri i fundores së temës— dhe kriteret e tjera të përdorshin për ndarjen në klasa ose nënklasa etj. Kështu, mungesa e mbaresave në njëjës të së tashmes dëftore zbatohet si kriter themelor për t'i veçuar foljet me temë më zanore pa -j si zgjedhim më vete. Mirëpo, po të zbatohet në mënyrë konsekuente ky kriter, këto folje duhet të bashkoheshin në një zgjedhim me foljet me temë më bashkëtingëllore, të cilat gjithashtu nuk marrin mbaresa në tri vetat e para të njëjësit.

Vërejtjeve tona lidhur me këtë zgjedhim do t'u shtonim edhe ato të G. Bevingtonit, i cili vë në dukje edhe dy pika të tjera të qortueshme të zgjedhimit të tretë. E meta e parë ka të bëjë me asimetrimin numerike të këtij zgjedhimi. Siç vëren Bevingtoni, «ndërsa zgjedhimi i parë dhe i dytë përmbajnë secili qindra folje, zgjedhimi i tretë ka gjithë-gjithë shtatë folje të rregullta, të shpërndara në tri klasa dhe gjashtë folje «të parregullta» (supletive)³¹. Një e metë tjetër e këtij klasifikimi, po sipas tij, është se shqipja ka tri folje të tjera, *iki*, *hipi* dhe *eci*, të cilat në të vërtetë janë e kundërta e foljeve si *pi*, pasi dalin me temë më bashkëtingëllore, po marrin mbaresat e së tashmes njëjës të foljeve me temë më zanore, khs. *iki*, *ikën*, *ikën* dhe *punoj*, *punon*, *punon*. «Po të ndiqej e njëjta logjikë, përfundon ky autor, atëherë do të duhej edhe një klasifikim i katërt, ashtu si zgjedhimi i tretë për shtatë foljet e sipërpërmendura³².»

Pra, ndërsa pritej që në gramatikën akademike të zinte vend varianti më i thjeshtë me dy zgjedhime, aty gjejmë një klasifikim tepër të diskutueshëm. Në të vërtetë, këtu kemi një tërheqje të autorit të kreut të foljes në këtë gramatikë dhe zbatimin e një skeme të propozuar nga F. Agalliu në diskutimin rreth problemit të klasifikimit të foljeve në zgjedhime. Ky i fundit nisej nga ideja se «për përcaktimin e zgjedhimeve nuk duhet të mbështetemi vetëm në tingullin fundor të temës së kohës së tashme të mënyrës dëftore», por duhen mbajtur parasysh «edhe mbaresat e tri vetave të njëjësit, madje këto në radhë të parë». Dhe, meqë foljet e tipit *pi*, *di*, *ha* etj. nuk marrin mbaresa në tri vetat e para, Agalliu propozonte që zgjedhimi i foljeve të këtij tipi të përbënte një ndarje me vete dhe, sipas rendit, duhet të vinte i fundit, sepse ishte joproduktiv dhe, për të, «renditja e zgjedhimeve sipas prodhimtarisë (produktivitetit) është e drejtë»³³.

9. Ndër skemat më të fundit, me interes për t'u përmendur është klasifikimi i propozuar nga G. Bevingtoni, i cili, ndonëse e pranon ndarjen e foljeve në dy grupe sipas karakterit të temës, dallon prej gjithë autorëve të tjerë që pranojnë dy zgjedhime, pasi për ndarjen e mëtejshme të secilit grup në nëngrupe mbështetet në llojin e modifikimeve të temës. Këto modifikime autori i kësaj sprove i ndan në modifikime tingullore dhe modifikime të temës foljore. Më tej, modifikimet tingullore i ndan në automatike dhe joautomatike. Në të parat fut ato ndërrime fonemore që, sipas tij, janë «morfologjikisht dhe fonologjikisht të kushtëzuara», kures në joautomatiket fut ndërrimet që janë veçori e vetë foljes dhe që, si të tilla, nuk mund të parashikohen³⁴.

Skema e propozuar prej tij është kjo:

Zgjedhimi i foljeve me temë më zanore

Gjedhja kryesore (vetëm me mbaresa): *laj*, *fshij*, *iki*

I. Modifikime automatike:

1) *elo* : *ye/ua* në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore: *punoj*, *rrëfej*.

2) *ye/ua* : *elo* në të kryerën e thjeshtë njëjës: *shkruej*, *lyej*.

³¹ Në të vërtetë, lista në fjalë përmban 14 folje të parregullta, nga të cilat nëntë folje supletive dhe pesë josupletive (shih «Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II, Tiranë, 1976, f. 243).

³² G. L. Bevington, On classifying Albanian Verbs, në «Papers for the V Congress of Southeast European Studies», Belgrade, September 1984, Slavica Publishers, p. 60.

³³ F. Agalliu, Diskutim rreth problemit të klasifikimit të foljeve në zgjedhime, SF, 1969, 3, f. 204.

³⁴ G. L. Bevington, On classifying Albanian Verbs, art. i cit., p. 60.

II. Modifikime prodhuese joautomatike – zgjerim i temës me një bashkëtingëllore:

- 1) *-(j)t- mbaj, mbroj, gjej;*
- 2) *-r- bëj, hyj.*

III. Modifikime sporadike, p.sh. *blej–blini–blerë* (khs. *rrëfyer*), *vij–vjen–erdha–ardhur* etj.

Zgjedhimi i foljeve me temë më bashkëtingëllore

Gjedhja kryesore (vetëm mbaresa): *hap, vendos, pi*

I. Modifikime automatike – *(j)e* bëhet *i* në vetën e dytë të së tashmes dëftore, në të pakryerën, në të kryerën e thjeshtë dhe në pësore: *fsheh, ndez.*

II. Modifikime prodhuese joautomatike:

A. *(j)e* : *o* në të kryerën e thjeshtë:

- 1) *bazë–heq, dredh;*
- 2) modifikime automatike zanoresh–palatalizim i mbylltores velare të temës dhe apofoni e zanores tematike: *pjek, djeg.*
- 3) modifikim prodhues joautomatik i zanores – *a/o* në vetën e parë njëjës dhe në vetën e parë dhe të tretë shumës të së tashmes: *njoh, marr.*

B. *t* : *s* në vetën e parë njëjës dhe në vetën e parë dhe të tretë shumës të së tashmes:

- 1) *bazë pyes, mbes*
- 2) me *a* në vetën e parë njëjës dhe në vetën e parë dhe të tretë shumës të së tashmes – *humbas, trokas.*

C. me # : *zanore* e temës në të tashme: të kryerën e thjeshtë dhe një zgjerim i temës në të tashmen, që shfaq gjedhen 2B të mësipërme – *përkas, flas, vras.*

D. *ë* : *ur* në të kryerën e thjeshtë – *vë, zë.*

III. Modifikime sporadike:

A. Tingujsh: *vdes–vdiqa–vdekur*

B. Morfeme të pjesshme: *ha* : *hëngra*
lë : *lashë*
lind: *leva*

C. Supletivizëm: *shoh* : *pashë, rri* : *ndenja*

Përveç këtyre, autori i kësaj sprove klasifikimi shton dhe një listë «foljesh të parregullta», si *jam, kam, them, vete* dhe *dua*³⁵.

Po edhe ky klasifikim, me gjithë përpjekjen e autorit të tij për ta paraqitur si një minimum rregullash të fonologjisë gjenerative, nuk e zgjidh problemin. Ndër vërejtjet kryesore që mund t'i bëhen, është se koncepti i temës lihet në mes, duke u zëvendësuar me kriterin e ndërrimeve që pëson tema. Përveç kësaj, ka edhe pika të tjera të qortueshme, si p.sh. përfshirja në një paradigmë e trajtave letrare dhe joletrare, si të *lind – leva* apo trajtimi i trajtës *lashë* si temë e zgjeruar e *lë* etj.

10. Numri i madh i zgjedhimeve që kanë rezultuar duke u nisur nga fundoret e paskajores gege, ka qenë arsyeja kryesore që i ka detyruar të gjithë autorët e mëvonshëm të gramatikave të shqipes që t'i drejtohen temës të së tashmes si kriter kryesor për klasifikimin në zgjedhime, duke ndjekur, krahas këtij kriteri, edhe disa kritere ndihmëse. Megjithatë, edhe duke marrë si bazë temën e së tashmes, nuk është arritur të jepet një klasifikim i pranueshëm i foljeve në zgjedhime. Edhe variantet e përpunuara nga Dozoni, Sheperi dhe Demiraj (varianti me dy zgjedhime), ndonëse janë më të thjeshta, kanë, megjithatë, pika të qortueshme.

Një nga pikat e dobëta të këtyre klasifikimeve është lënia jashtë zgjedhimeve e foljeve të ashtuquajtura të parregullta, një pjesë e të cilave nuk janë më të parregullta se shumë folje të zgjedhimit të tretë. Kështu, foljet *lë, vete, them* etj. nuk janë më të parregullta se foljet *vë, zë, di, fle, ngre* apo *shtie* që i takojnë zgjedhimit të tretë. Folje të tilla në paradigmën e tyre janë të

³⁵ G. L. Bevington, On Classifying Albanian Verbs, art. i cit., p. 62–63.

stabilizuara mirë, nuk kanë dysorë ose parregullsi të tjera, pra, ajo që i bën të «parregullta» këto folje është se gjedhja e tyre e zgjedhimit është e izoluar. Në diskutimin e tij rreth varianteve të propozuara nga Demiraj, F. Agalliu shprehet se nuk duhej të kishte folje të parregullta, pasi parregullsia e foljeve të ashtuquajtura të parregullta «përmbledhet në ndryshimet e temës, ndryshime që mund të jenë ose të një karakteri fonetik tepër largvajtës, ose që kanë të bëjnë me fenomenin e supletivizmit»³⁶. Prandaj ai propozon që «grupimi në zgjedhime edhe i të ashtuquajturave folje të parregullta është i leverdishëm në pikëpamje praktike»³⁷. Nga pikëpamja praktike, një pikë e dobët e të gjitha klasifikimeve në zgjedhime të foljeve të shqipes dhe, në përgjithësi të foljeve në gjuhë me ndërrime të shumta në eptimin foljor, është se folësit, për të gjetur paradigmën e një foljeje, i duhet të bëjë dy operacione mendore: së pari, të identifikojë se cilit zgjedhim i përket një folje e dhënë dhe, së dyti, të kujtojë si e kanë paradigmën foljet e këtij zgjedhimi, pasi etiketimi «folje e zgjedhimit të parë» etj. në vetvete nuk thotë asgjë për paradigmën e foljes. Edhe skema e propozuar prej Bevingtonit, me gjithë thelbin e saj racional, nuk arrin t'i kapërcejë mangësitë e zgjedhimeve të mëparshme.

Përfundimi që mund të nxirret prej shqyrtimit të historisë së klasifikimit në zgjedhime është se folja e shqipes nuk mund të futet në kallëpet e ndërtuara për foljen latine apo të gjuhëve neolatine. Folja e shqipes, siç dihet, është larg prej gjuhëve të mësipërme. Së pari, nuk ka dëshmi që ajo të ketë pasur një formë të veçantë për paskajoren, e cila do të shërbente edhe në këtë gjuhë si bazë për klasifikimin e foljeve në zgjedhime. Edhe paskajorja e gegërishtes, prej së cilës janë nisur disa autorë për klasifikimin në zgjedhime, nuk paraqet një rregullsi të tillë si në latinisht. Ajo që mbetet kur formës së paskajores gege i heqim prapashtesën e paskajores, do të jetë një temë më bashkëtingëllore ose më zanore, ndryshe nga gjuhët e mësipërme, ku gjithnjë mbetet një temë më zanore. Për më tepër, po të vërehen ndarjet në zgjedhime të foljeve të latinishtes ose të bijave të saj, del se ato janë bërë duke u mbështetur në një kriter të vetëm, i cili nuk bie në kundërshtim me kriterin e mbaresave të së tashmes: foljet latine të zgjedhimit të parë kanë të njëjtat mbaresave vetore për njëjës. Një gjë e tillë nuk ndodh në gjuhën shqipe, ku foljet me temë më zanore plus *-j* dhe ato me temë më zanore ose tog zanor, të cilat disa nga gramatikanët i futin në një zgjedhim, ndryshojnë shumë për sa u përket mbaresave vetore të njëjës të së tashmes dëftore. Në këtë pikë, foljet me temë më zanore të tipit *pi, di, shpie* etj. sillen si foljet me temë më bashkëtingëllore. Kështu, *pi* dhe *hap* në tri vetat e njëjës zgjedhohen njëlloj. Kjo i ka dhënë shkas edhe propozimit për ndarjen e foljeve me temë më zanore në dy zgjedhime, ndarje që, siç u tha, ka zënë vend në gramatikën e Akademisë. As vënia e temës të së tashmes në bazë të klasifikimit në zgjedhime nuk ka dhënë përfundime të kënaqshme, gjë që u përpoqëm të shpjegojmë më sipër.

Karakteri i diskutueshëm i klasifikimeve të bëra shpjegohet me atë që bazat e ndarjes në zgjedhime të foljeve të shqipes nuk i përgjigjen gjendjes së sotme të leksikut të saj foljor. Këto klasifikime janë, në thelb, një kopjim i gjedheve të gjuhëve të tjera, gjedhe që nuk i përshtaten foljes së shqipes. Dëshmi e kësaj janë jo vetëm moria e kriterëve të ndjekura, që kanë shpurrë në përfundime shumë të ndryshme, por edhe numri i madh i klasifikimeve të dhëna deri tani, pa arritur dot në një klasifikim të paqortueshëm.

11. Meqenëse ndarja në zgjedhime sipas gjedhes së gjuhëve romane nuk ka dhënë përfundime të kënaqshme, mendojmë se i duhet drejtuar një tradite tjetër, dhe pikërisht asaj së gjuhëve si gjermanishtja dhe anglishtja. Në gramatikat e këtyre të fundit foljet ndahen në klasa dhe jo në zgjedhime, duke u mbështetur në praninë ose mungesën e ndërrimeve në

³⁶ Megjithatë, edhe ky autor mendon se përjashtim duhet bërë vetëm për foljet *jam, kam* e *them*, të cilat i «takojnë një zgjedhimi të veçantë, të vjetër, por jo produktiv» (F. Agalliu, Diskutim rreth problemit të klasifikimit të foljeve në zgjedhime, f. 203.)

³⁷ Po aty.

temën e tyre. Arsyeja për një gjë të tillë është se folja e shqipes, nga pikëpamja e dukurive morfonologjike, ngjan shumë me foljen e gjuhëve të mësipërme³⁸.

Për ndarjen e foljeve në gjedhe eptimi, të cilat ne parapëlqejmë t'i quajmë *klasa* dhe jo zgjedhime, ne do të mbështetemi vetëm në dy kritere. Si kriter themelor do të marrim karakterin e fundores së temës të së tashmes së dëftores veprore, duke i ndarë foljet në dy klasa themelore: në folje me temë më zanore dhe në folje me temë më bashkëtingëllore. Më tej, për ndarjen e foljeve të secilës klasë në nënklasa, do të mbështetemi në numrin e temave të eptimit. Në këtë mënyrë, numri i kriterëve rrudhet në dy, duke mënjanuar disa nga kriteret e ndjekura në Gramatikën e Akademisë, dhe pikërisht kriterin në bazë të të cilit foljet ndahen në të rregullta dhe në të parregullta, kriterin që ka të bëjë me mbaresat vetore, dhe kriterin sasior³⁹. Kjo e bën këtë mënyrë grupimi të foljeve më të pranueshme, më të thjeshtë dhe më të lehtë për t'u zbatuar.

Kriteret e propozuara më sipër për ndërtimin e kësaj skeme të klasifikimit të foljeve nuk janë të panjohura. Kriterin e parë e gjejmë te Dozoni dhe te Sheperi dhe, së fundi, edhe te Bevingtoni. Kurse kriteri i numrit të temave, siç u vu në dukje më lart, është zbatuar nga De Rada. Ndarja në klasa mendojmë se ka disa përparësi në krahasim me klasifikimin në zgjedhime. Së pari, ajo përfshin të gjitha foljet, d.m.th. nuk ka folje të parregullta (ose numri i tyre mund të rrudhet në minimum) dhe kjo e bën klasifikimin më pak të rënduar me nëndarje. Së dyti, shkurtohet një hallkë në procesin e identifikimit të një foljeje, pasi, për të gjetur format e saj, i referohemi drejtpërdrejt foljes, pa qenë nevoja të kujtojmë më parë ç'zgjedhimi i përket ajo dhe pastaj të se si bëjnë foljet e këtij zgjedhimi. Së treti, grupimi i foljeve në klasa është mjaft i përshtatshëm për fjalorët e shqipes ose shqip-gjuhë e huaj, sepse tabelat e shumta të zgjedhimit që kanë fjalorët e botuar gjer më sot, mund të zëvendësohen me një pasqyrë të vetme, në të cilën foljet renditen sipas numrit të temave, ashtu siç kanë bërë O. Buholci dhe F. Fidleri në fjalorin e tyre shqip-gjermanisht⁴⁰. Së fundi, ndarja në klasa mendojmë se është e përshtatshme edhe për kategorizimin e foljeve në analizat sintaksore kompjuterike, pasi përkatësia e foljes në një klasë të caktuar nuk ndryshon, kurse ndarjet në zgjedhime mund të ndryshojnë nga njëra gramatikë në tjetrën.

12. Sipas kriterit të parë, d.m.th. sipas natyrës së temës, foljet e shqipes ndahen në dy klasa të mëdha: folje me temë më zanore dhe folje me temë më bashkëtingëllore. Më tej, secila nga këto klasa ndahet në nënklasa duke u mbështetur në numrin e temave të eptimit. Sipas këtij kriteri, në nënklasën e parë të secilës klasë do të futen foljet pa ndërrime, d.m.th. me një temë, kurse në nënklasën e dytë foljet me ndërrime, pra foljet me dy a më shumë tema. Më tej, secila nga nënklasat e dyta, mund të ndahet në grupe në varësi të numrit të temave⁴¹.

Në formën e saj të plotë, skema jonë e klasifikimit të foljeve në grupe është kjo.

Klasa I

Në klasën e parë përfshihen foljet me temë më zanore ose më tog zanor. Kjo klasë ndahet në dy nënklasa:

Nënklasa I ngërthen foljet pa ndërrime, d.m.th. me një temë eptimi gjatë gjithë paradigmes. Të tilla janë foljet me temë më zanoret *-a(j)*, *-i(j)*, *-y(j)* (me përjashtim të *hyj*): *laj*, *thaj*, *fshij*, *nxij*, *shtyj*, *pi* etj.

<i>la-j</i>	la-va/ la-më	la-hem	la-rë
<i>fshi-j</i>	fshi-va/ fshi-më	fshi-hem	fshi-rë

³⁸ R. Memushaj, *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1989, f. 210.

³⁹ Shih R. Memushaj, «Shqipja standarde», Tiranë, 2002, f. 94–97.

⁴⁰ O. Bucholz, W. Fiedler, G. Uhlisch, *Wörterbuch albanisch-deutsch*, Leipzig, 1977, f. 708-714.

⁴¹ Varianti i parë i këtij grupimi të foljeve në klasa është paraqitur në librin «Morfonologji e eptimit...», vep.cit., f. 150–152.

pi *pi-va/ pi-më* *pi-hem* *pi-rë*⁴²

Nënklasa II përfshin foljet me ndërrime në zanoren e temës. Brenda saj dallohen këto grupe:

Grupi i parë përfshin foljet me dy tema eptimi:

(a) Foljet me temë më *-o* dhe *-e* që pësojnë ndërrimet *o~ua* përkatësisht *e~ye*, si: *punoj* (*puno-va~punua-m*), *kthej* (*kthe-va~kthye-m*) etj.

<i>puno-j</i>	<i>puno-ni</i>	<i>puno-va/ punua-m</i>	<i>puno-het</i>	<i>punua-r</i>
<i>kthe-j</i>	<i>kthe-ni</i>	<i>kthe-va/ kthye-m</i>	<i>kthe-het</i>	<i>kthye-r</i>

(b) Foljet që në të kryerën e thjeshtë dalin me ndërrimin *#~(j)t*, si *gjej* (*gje-j~gje-ta*), *mbaj* (*mba-j~mba-jta*) etj.

<i>gje-j</i>	<i>gje-ni</i>	<i>gjet-a/ gjet-ëm</i>		<i>gjetur</i>
<i>mba-j</i>	<i>mba-ni</i>	<i>mbajt-a/ mbajt-ëm</i>	<i>mba-het</i>	<i>mbajt-ur</i>

(c) Foljet *blej*, *bëj*, *hyj*, *fyej* dhe *rri*:

<i>ble-j</i>	<i>bli-ni</i>	<i>ble-va/ ble-më</i>	<i>bli-het</i>	<i>ble-rë</i>
<i>bë-j</i>	<i>bë-ni</i>	<i>bër-a/ bë-më</i>	<i>bë-het</i>	<i>bë-rë</i>
<i>hy-j</i>	<i>hy-ni</i>	<i>hyr-a/ hy-më</i>	<i>hy-het</i>	<i>hy-rë</i>
<i>fye-j</i>	<i>fye-ni</i>	<i>fye-va/ fye-m</i>	<i>fy-hem</i>	<i>fye-r</i>
<i>rri</i>	<i>rri-ni</i>	<i>ndenj-a/ ndenj-ëm</i>	<i>rrihet</i>	<i>ndenj-ur</i>

Grupi i dytë përfshin foljet me tri tema eptimi. Ky grup ndahet në tri nëngrupe:

(a) foljet me temë më *-ua* dhe *-ye* që pësojnë ndërrimet *ua~o* përkatësisht *ye~e*, si *bluaj*, *lyej* etj., të cilat në formën pësore i mbledhin këto grupe në u përkatësisht në y:

<i>blua-j</i>	<i>blua-ni</i>	<i>blo-va/ blua-m</i>	<i>blu-het</i>	<i>blua-r</i>
<i>lye-j</i>	<i>lye-ni</i>	<i>le-va/ lye-m</i>	<i>ly-hem</i>	<i>lye-r</i>

(b) foljet me temë më *-ua* që, përveç ndërrimeve *ua~o* dhe *ua~u*, në të kryerën e thjeshtë e zgjerojnë temën me *-jt*: *gjuaj*, *huaj*, *kruaj*, *luaj*, *quaj*, *truaj*:

<i>gjuaj-j</i>	<i>gjuaj-ni</i>	<i>gjuajt-a/ gjuajt-ëm</i>	<i>gju-het</i>	<i>gjuajt-ur</i>
<i>kruaj-j</i>	<i>kruaj-ni</i>	<i>kruajt-a/ kruajt-ëm</i>	<i>kru-het</i>	<i>kruajt-ur</i>

(c) foljet *ha*, *shtie*, *ndiej*, *ziej*, *përziej*:

<i>ha</i>	<i>ha-ni</i>	<i>hëngr-a/ hëngr-ëm</i>	<i>ha-het</i>	<i>ngrë-në</i>
<i>shtie</i>	<i>shti-ni</i>	<i>shti-va/ shti-më</i>	<i>shti-het</i>	<i>shtë-në</i>
<i>ndiej-j</i>	<i>ndie-ni</i>	<i>ndje-va/ ndie-m</i>	<i>ndi-hem</i>	<i>ndie-r</i>
<i>ziej-j</i>	<i>zie-ni</i>	<i>zje-va/ zie-m</i>	<i>zih-et</i>	<i>zie-r</i>

Grupi i tretë përmbledh foljet me katër dhe pesë tema eptimi, të cilat janë në numër të kufizuar. Foljet e këtij grupi mund t'i ndajmë në dy nëngrupe:

(a) foljet që në të kryerën e thjeshtë dalin me ndërrimin *#~r*, si: *vë*, *zë*, *nxë lë*, *bie* e *shpie*, shumica e të cilave pësojnë ndërrime të tjera vokalice.

<i>lë</i>	<i>li-ni</i>	<i>la-shë/ le/ la-më</i>	<i>li-het</i>	<i>lë-në</i>
<i>vë</i>	<i>vi-ni</i>	<i>vur-a/ vu-më</i>	<i>vi-het</i>	<i>vë-në</i>
<i>bie</i> 'sjell'	<i>bi-ni</i>	<i>prur-a/ pru-</i>	<i>bi-het</i>	<i>pru-rë</i>

⁴² Por folja *rri*, që nga fundorja është shumë e ngjashme me *pi*, nuk futet në këtë grup, pasi në të kryerën e thjeshtë dhe në format që rrjedhin prej saj del me një temë supletive.

bie ‘rrezohem’ *bi-ni* *ra-shë/ re/ ra-më* *rë-në*

(b) foljet *dua*, *vij* dhe *vete*:

<i>dua</i>	<i>do</i>	<i>do-ni</i>	<i>desh-a/ desh-ëm</i>	<i>du-het</i>	<i>dash-ur</i>	
<i>vi-j</i>	<i>vje-n</i>	<i>vi-ni</i>	<i>erdh-a/ erdh-ëm</i>	<i>vi-het</i>	<i>ardh-ur</i>	<i>eja</i>
<i>vete</i>		<i>ve-mi</i>	<i>vajt-a/ vajt-ëm</i>	<i>va-fsh</i>	<i>vajt-ur</i>	

KLASA II

Klasa e dytë përfshin foljet me temë më bashkëtingëllore. Edhe kjo klasë ndahet në dy nënklasa.

Nënklasa I ngërthen foljet me temë më bashkëtingëllore pa ndërrime, si: *hap*, *mposht*, *ndal*, *plas*, *vulos* etj.

<i>hap</i>	<i>hap-ni</i>	<i>hap-a/ hap-ëm</i>	<i>hap-et</i>	<i>hap-ur</i>
<i>palos</i>	<i>palos-ni</i>	<i>palos-a/ palos-ëm</i>	<i>palos-et</i>	<i>palos-ur</i>

Këtu do të futen edhe foljet *ec*, *ik*, *hip*, të cilat, ndonëse në gramatikën e Akademisë dhe në fjalorët normativë jepen në format *eci*, *iki*, *hipi*, për ne janë folje me temë më bashkëtingëllore dhe duhen trajtuar si gjithë foljet e tjera më bashkëtingëllore⁴³.

Nënklasa II përfshin foljet më bashkëtingëllore me ndërrime të temës. Sipas numrit të temave, kjo nënklasë ndahet në tri grupe:

Grupi i parë përfshin foljet me dy tema, ku hyjnë foljet me ndërrimin *t~s* në vetën III njëjës të së pakryerës dëftore, si *godit* (*godit~godis-te*), *ngjit*, *përpëlit*, *fut*, *këput* etj. Në këtë grup hyn edhe folja *pyes*, që del gjithashtu me dy tema (*pyes~pyet*).

<i>godit</i>	<i>godis-te</i>	<i>godit-a/ godit-ëm</i>	<i>godit-et</i>	<i>godit-ur</i>
<i>pyes pyet</i>		<i>pyet-a/ pyet-ëm</i>	<i>pyet-et</i>	<i>pyet-ur</i>

Grupi i dytë përfshin foljet me tri tema që në vetën e dytë njëjës ose shumës të së tashmes dëftore veprorë metafonizojnë zanoren e temës. Ky grup ndahet në tri nëngrupe:

(a) foljet më *-as* dhe *-es*, të cilat në vetën e dytë njëjës të së tashmes dëftore veprorë e ndërrojnë *s* në *t* (foljet më *-as* pësojnë edhe ndërrimin *a~e*), kurse në vetën e dytë shumës të së tashmes dalin me ndërrimin *e~i*, si: *bërtas*, *trokas*, *thërras* etj. dhe *bares*, *paraqes*, *pres* “shokun”, *qes*, *shes*, *zbres*:

<i>bërtas</i>	<i>bërtet</i>	<i>bërtit-ni</i>	<i>bërtit-a</i>	<i>bërtit-ur</i>
<i>shes</i>	<i>shet</i>	<i>shit-ni</i>	<i>shit-a</i>	<i>shit-ur</i>
<i>pres</i>	<i>pret</i>	<i>prit-ni</i>	<i>prit-a</i>	<i>prit-ur</i>

(b) foljet *rrah* dhe *njoh*, të cilat në vetën e dytë njëjës dalin me ndërrimin *o~e* ose *a~e*, kurse në vetën e dytë shumës me ndërrimin *e~i*:

<i>rrah</i>	<i>rreh</i>	<i>rrih-ni</i>	<i>rrah-a</i>	<i>rrah-ur</i>
<i>njoh</i>	<i>njeh</i>	<i>njih-ni</i>	<i>njoh-a</i>	<i>njoh-ur</i>

Në këtë grup do të futim edhe foljen *marr*, e cila, për shkak të zëvendësimit të formës së rregullt *mirrni* të vetës së dytë shumës të së tashmes dëftore veprorë nga forma analogjike *merrni*, del me tri tema dhe jo me katër si folja *dal*.

⁴³ Që të A. Dozoni këto folje jepen në dy trajta: *hip* dhe *hipënj*, *lyp* dhe *lypënj*, *ik* dhe *ikënj* (A. Dozon, Manuel de la langue chkepe..., vep. e cit., p. 252); dy vjet më pas, edhe G. Jungu i jep këto folje pa-*i*: *ik*, *hyp* (G. Jung, Elementi grammaticali della lingua Albanese, vep. e cit., p. 80). Më hollësisht për këto folje shih shkrimin tonë «Rreth lëvizjeve në sistemin foljor të shqipës», Studime albanologjike, II, 1996, f. 146–152.

marr merr merr-ni mor-a marr-ë

(c) foljet që në të kryerën e thjeshtë e apofonizojnë zanoren e temës, duke dalë më ndërrimet (j)e~o dhe a~o, si: *heq, ndjell, pjell, sjell* dhe *marr* etj.

heq heq hiq-ni hoq-a heq-ur
sjell sjell sill-ni soll-a sjell-ë

Grupi i tretë përfshin foljet me katër tema. Ky grup ndahet në dy nëngrupe: foljet *flas, ngas, ngjas, shkas, vras, gërgas, pres* “me thikë”, *vdes* dhe *dhjes*, të cilat, përveç ndërrimeve të foljeve më -as dhe -es të grupit të dytë, në të kryerën e thjeshtë dalin me ndërrimin s~#; në nëngrupin e dytë hyn vetëm folja *dal*.

flas flet flit-ni fol-a fol-ur
ngas nget ngit-ni nga-va nga-rë
pres pret prit-ni pre-va pre-rë
vdes vdis-ni vdiq-a vdek-ur
dal del dil-ni dol-a dal-ë

Grupi i katërt përfshin foljet *jap* dhe *shoh* dhe të cilat dalin me pesë tema eptimi.

jap jep jep-ni dha-shë/ dhe jep-et dhë-në
shoh sheh shi-ni pa-shë/ pe shi-het pa-rë

Grupi i pestë përfshin foljet *jam, kam* e *them*, që kanë gjashtë ose shtatë tema eptimi:

ja-m je është ish-a qe-shë/ qe-më qo-fsha ji qe-në
ka-m, ke kish-a pat-a/ pat-ëm paç-a/ pas-të ki-ni pas-ur
the-m thua tho-të thu-het tha-shë/ tha-më thën-çi thua-j thë-në

13. Siç shihet, numri i klasave dhe i grupeve është shumë më i vogël se në gramatikën e Akademisë, ku secili nga tri zgjedhimet ndahet në një mori klasash e nënklasash, veç listës së foljeve të parregullta. Mbështetja vetëm në dy kriteret e bën këtë ndarje më të thjeshtë dhe, rrjedhimisht, më të pranueshme se klasifikimi në zgjedhime. Megjithatë, leksiku foljor i shqipes paraqet paradigma aq të larmishme, sa asnjë skemë klasifikimi, sado e përsosur të ishte, nuk do të mund t’i shpëtonte kritikës. Kështu, edhe në këtë klasifikim që paraqitëm, disa folje mbeten problematike, pasi për nga numri i temave dallojnë prej foljeve me fundore të ngjashme. Të tilla ndër foljet me temë më zanore janë *rri*, që është më afër me foljen *pi*, dhe *shtie*, që nga fundorja afron me *bie* e *shpie*; kurse ndër foljet me temë më bashkëtingëllor të tilla janë e *shoh* dhe *marr*, të cilat duhej të përfshiheshin e para me foljen *njoh*, kurse e *dyta* me foljet apofonike. Për t’i mbetur besnik kriterit të temave të eptimit, këto folje ne i kemi ndarë nga foljet me strukturë të ngjashme dhe jemi të vetëdijshëm se kjo përbën një të metë të këtij klasifikimi që nuk kemi arritur ta këpërcejmë.

Rami Memushaj
 Departamenti i gjuhësisë
 Universiteti i Tiranës